

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE – ALPEX SH.A

Njoftim

29 Gusht 2022

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike–ALPEX sh.a., ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Energjisë në Shqipëri dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji në Kosovë kërkesën për miratimin e dokumenteve që përbëjnë tërësinë e rregullave qeverisëse të ALPEX-it. ALPEX-i pas përmbylljes së procesit të konsultimit publik, ka reflektuar tek këto rregulla dhe procedura shumicën e sugjerimeve të dhëna nga palët e interesit. ALPEX-i e vlerëson si një tjetër hap të rëndësishëm drejt operacionalizimit të Bursës finalizimin dhe kërkesën për miratimin tek Autoritetet Rregullatore përkatëse, të këtyre grup – dokumentesh si më poshtë:

1. Rregullat e ALPEX – Kushtet e Përgjithshme;
2. Procedura e Tregtimit;
3. Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes;
4. Përkufizimet e ALPEX;

Falënderojmë palët e interesit për dhënien e sugjerimeve si dhe të gjithë ata që u përfshinë në procesin e hartimit të këtyre dokumenteve.

Kontakti

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike-ALPEX sh.a

Adresa: Rruga Liman Kaba, Rezidenca Olympic,
Hyrja 3, Kati 1, Zyra nr.1, Tirana, Albania.
Email: info@alpex.al